



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:077690
Datë: 11.03.2025
Numri i dokumentit: 06971737

AA.nr.289/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuçi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale, Hajrije Krasniqi, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, N.M, të cilin me autorizim e përfaqëson, Egzon Doli, avokat nga Gjakova, kundër të paditurave, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, dhe Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.928/2022, të datës 30.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 03.03.2025 merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, N.M, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.928/2022, i datës; 30.01.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.928/2022, të datës; 30.01.2024, është vendosur, “*I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit N.M, të cilin me autorizim e përfaqëson Egzon Doli, avokat nga Gjakova. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale*”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka ushtruar ankesë, përmes të autorizuarit të tij, Egzon Doli, avokat nga Gjakova, me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale nga Ligji për Konfliktet Administrative dhe Ligji për Procedurën Kontestimore dhe zbatim të gabuar, përkatësisht moszbatim të duhur të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, të ndryshohet dhe të gjykohet si në vijim: Aprovohet kërkesëpadija e paditësit për heshtje administrative ndaj të paditurave MMPHI dhe DUMM – Komuna e Gjakovës, ashtu që detyrohet e paditura e parë që të nxjerrë akt administrativ përmes të cilit obligon të paditurën e dytë që të lëshoj lejen e ndërtimit të kërkuar nga paditësi përmes aplikacionit – kërkesës së datës 10.11.2021 me pr. Prot. 07-351/02-34376 pranë DUMM – Komuna e Gjakovës – si kërkesë e miratuar në heshtje, ose të marr aktvendim që të aprovohet ankesa e paditësit dhe aktgjykimi i

ankimuar të priset dhe lënda kthehet në rigjykim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.

Të paditurat, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë dhe Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk kanë dhënë përgjigje në ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në lidhje me këtë çështje juridike të këtij konflikti administrativ, gjykata me Aktgjykimin A.nr.928/22 të datës 06.09.2023, e kishte aprovuar padinë e paditësit, duke detyruar të paditurën e dytë që të nxjerr vendim në lidhje me kërkesën e përsëritur të palës paditëse me nr. protokoli 07-351/02/02-34376 të datës 10.11.2021 dhe të njëjtin t'ia dorëzoj palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj. E paditura e dytë me vendimin Nr.07/351/01-34376 të datës 25.09.2023 e kishte shfuqizuar vendimin Nr.07/351/02-34376 të datës 14.09.2023, me parashtrësën e datës 02.10.2023 e kishte njoftuar palën paditëse për plotësim të dokumentacionit, ndërsa me Vendimin Nr.07/351/02-34376 të datës 06.11.2023 e kishte refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar. Pas këtij vendimi, paditësi kishte ushtruar ankesë tek e paditura e parë, me datë 16.10.2023 e cila sipas paditësit nuk kishte nxjerrë vendim në lidhje me ankesën.

Paditësi i për shkak heshtjes administrative të të paditurave, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me datë;19.04.2022, që të paditurat të nxjerrin aktvendim lidhur me kërkesën për leje ndërtime.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur për heshtje administrative ndaj të paditurave dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se “ Në lidhje me këtë çështje juridike të këtij konflikti administrativ, gjykata me Aktgjykimin A.nr.928/22 të datës 06.09.2023, e kishte aprovuar padinë e paditësit, duke detyruar të paditurën e dytë që të nxjerr vendim në lidhje me kërkesën e përsëritur të palës paditëse me nr. protokoli 07-351/02/02-34376 të datës 10.11.2021 dhe të njëjtin t'ia dorëzoj palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj. E paditura e dytë me vendimin Nr.07/351/01-34376 të datës 25.09.2023 e kishte shfuqizuar vendimin Nr.07/351/02-34376 të datës 14.09.2023, me parashtrësën e datës 02.10.2023 e kishte njoftuar palën paditëse për plotësim të dokumentacionit, ndërsa me Vendimin Nr.07/351/02-34376 të datës 06.11.2023 e kishte refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar. Gjykata gjeti se paditësi i pakënaqur me këtë vendim, paditësi kishte ushtruar ankesë tek e paditura e parë, me datë 16.10.2023 e cila sipas paditësit nuk kishte nxjerrë vendim në lidhje me ankesën. Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar i nxjerrë nga e paditura e dytë Komuna e Gjakovës është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Gjykata gjeti se e paditura e dytë ka marrë vendim në përputhje me kërkesën e paditësit dhe vendimi i i përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të ligjeve tjera materiale. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditësi as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ka prova të mjaftueshme për ti mbështetur pohimet e tij të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës është shkelur ndonjë dispozitë ligjore në dëm të paditësit.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë aktvendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrahi arsyetimin e të paditurës së dytë të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar. Gjykata gjeti se e paditura e dytë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale me rastin e marrjes së vendimit për refuzim të kërkesës për leje ndërtimore, duke ju referuar nenit 21, paragrafit 2 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, ku qartë përcaktohet: “Neni 21 Procedura për lëshimin e lejes ndërtimore- 2. Nëse organi kompetent vlerëson se dokumentacioni ndërtimor nuk është përgatitur në përputhje me kushtet ndërtimore dhe me dispozitat e këtij ligji, Kodit si dhe Ligjit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe zonat e veçanta të mbrojtura, nuk do të lëshojë lejen ndërtimore. Në rast se kërkesa për leje ndërtimore refuzohet, organi kompetent duhet të ofrojë sqarim të mirëfilltë për arsyet e refuzimit”. Kjo vërtetohet, ndër të tjera me Informatën e lëshuar nga KEDS, me numër 4/60 të datës 01.11.2023 me të cilën njoftohet e paditura e dytë që në lidhje me çështjen në fjalë Departamenti i Shërbimit për Konsumatorë pas shqyrtimit të kësaj kërkesë kishte refuzuar Pëlqimin Parimor për këto prona pasi që në këto prona kalon linja ajrore e tensionit të ulët 0.4kV dhe linja ajrore e tensionit të mesëm 10kV. Në ndërlidhje me këtë, gjykata nuk i fali besimin provës së propozuar nga ana e paditësit në të cilën vërehet shkrimi me dorë si në vijim: “Dokumentet janë plotësuar sipas kërkesës së QRTK me datën 14.02.2022, Gjakovë, 14.02.2022”, për faktin që paditësi nuk ka paraqitur në gjykatë një dokument të qartë dhe të plotë me të gjitha informacionet në lidhje me parcelat ku kishte kërkuar leje ndërtimi, në të cilin qartë do të jepej informacion nëse ekziston Pëlqimi nga ana e QKRMT-së e që do të mund t'i kundërvihet Njoftimit të QKRT-së për mosdhënie të Pëlqimit në lidhje me këtë ndërtim. Gjykata vlerësoi se kërkesat e tilla janë të natyrës prekluzive, zbatimi i së cilave është i detyrueshëm si për të paditurën e dytë, ashtu edhe për palën paditëse dhe për cilindo subjekt juridik që i nënshtrohet procedurës së kërkesës për pajisje me leje të ndërtimit. Natyra prekluzive e këtyre kërkesave imponon detyrimin e palëve kërkuese, në këtë rast të palës paditëse që të njëjtat ti zbatojnë, çka rezulton se në rastin konkret, pëlqimet në fjalë mungojnë, ndërkaq vendimi i të paditurës së dytë për refuzimin e dhënies së lejes për ndërtimin mbi bazën e mungesës së këtyre pëlqimeve, është i ligjshëm dhe i drejtë. Gjykata refuzoi pretendimet e paditësit për lëshimin e lejes ndërtimore mbi bazën e heshtjes administrative, përkatësisht mbi bazën e nenit 21, paragrafi 3 të Ligjit për Ndërtim, për faktin që lëshimi i lejes ndërtimore mbi bazën e heshtjes administrative ndërlidhet dhe imponon plotësimin e kushteve tjera të parapara në këtë ligj, siç janë të parapara me nenin 21, paragrafin 2 të po këtij Ligji. Gjykata po ashtu refuzoi pretendimet e paditësit sa i përket zbatimit të nenit 12 të Ligjit për Ndërtim. Me këtë rast gjykata ju referua nenit 12 të Ligjit për Ndërtim në të cilin thuhet: “Neni 12 Validiteti i dokumentacionit të aprovuar paraparak ndërtimor Dokumentacioni ndërtimor i aprovuar për një projekt të mëhershëm konsiderohet i vlefshëm për ndonjë projekt të ardhshëm në varësi të kërkesave të planit rregullativ urban ose kushteve ndërtimore specifike për atë projekt”. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se paditësi thirret në dorëzimin e të gjithë dokumentacionit për legalizimin e objektit në ngastrën kadastrale 1289/4 në vitin 2012, ndërkaq në anën tjetër, në procedurën administrative që i ka paraprirë këtij konflikti administrativ, bëhet fjalë për refuzimin nga e paditura e dytë për dhënien e lejes për parcelat me numër 01289-7, 1289-8 dhe 1289-9 ZK Brekoc. Nisur nga kjo gjendje faktike, gjykata gjeti se në rastin konkret, përjashtohet aplikueshmëria e nenit 12 të Ligjit për ndërtim, për faktin që në rastin konkret të zhvillimit të këtij konflikti administrativ kemi të bëjmë me kërkesa specifike që implikojnë zbatimin e detyrueshëm të Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, i cili për nga natyra është ligj specifik, pra kushtet ndërtimore në rastin konkret janë të natyrës specifike, gjë që imponon bartësin e kërkesës për leje ndërtimore që të plotësoj specifikisht kushtet e përcaktuara nga e paditura e dytë, gjë që i njëjti në bazë të shkresave të lëndës, qartazi nuk i ka plotësuar. Gjykata refuzoi poashtu pretendimet e paditësit me të cilat pretendon që kemi shkelle të pastërt ligjore e cila duhet të evitohet nga e paditura e dytë, duke marrë parasysh kërkesën e saj për plotësim dokumentacioni, si të tërësisht të pabazuar. Kjo për faktin që me rastin e detyrimit nga Gjykata përmes Aktgjykimin paraparak për të vendosur në lidhje me kërkesën e palës paditëse, e paditura

ka ndërmarrë në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, duke rifilluar procedurën administrative dhe duke rikërkuar nga pala paditëse plotësimin e kërkesës për leje me dokumentet specifike. Thënë këtë, është evidente që e paditura e dytë ka vepruar gjatë tërë kohës me kompetencë dhe në përputhje me autorizimet e veta ligjore duke zhvilluar procedurën administrative sipas kërkesës së Gjykatës dhe brenda kufijve të vet ligjor. Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës së dytë ndaj kërkesës së palës dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform autorizimeve të veta me ligj. Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë. Prandaj gjykata përfundimisht konstatoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thënie e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura”.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase ankuesi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktësisht se ku qëndrojnë shkeljet e dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPK-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se “...gjykata e shkallës së parë në kundërshtim me faktet dhe provat e çështjes që janë dorëzuar si pranë kësaj gjykate, ashtu edhe pranë dy të paditurave, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për lëshimin e lejes ndërtimore, me çka aktgjykimi i atakuar më këtë ankesë është në shpërputhje të plotë me deklaratimet – pretendimet e paditësit, veprimet apo mosveprimet e të paditurave, si dhe faktet vendimtare të çështjes”. Kolegji i apelit duke i vlerësuar këto pretendime ankimore, vëren se gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kur ka konstatuar se “gjykata gjeti se paditësi thirret në dorëzimin e të gjithë dokumentacionit për legalizimin e objektit në ngastrën kadastrale 1289/4 në vitin 2012, ndërkaq në anën tjetër, në procedurën administrative që i ka paraprirë këtij konflikti administrativ, bëhet fjalë për refuzimin nga e paditura e dytë për dhënien e lejes për parcelat me numër 01289-7, 1289-8 dhe 1289-9 ZK Brekoc. Nisur nga kjo gjendje faktike, gjykata gjeti se në rastin konkret, përjashtohet aplikueshmëria e nenit 12 të Ligjit për ndërtim, për faktin që në rastin konkret të zhvillimit të këtij konflikti administrativ kemi të bëjmë me

kërkesa specifike që implikojnë zbatimin e detyrueshëm të Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, i cili për nga natyra është ligj specifik, pra kushtet ndërtimore në rastin konkret janë të natyrës specifike, gjë që imponon bartësin e kërkesës për leje ndërtimore që të plotësoj specifikisht kushtet e përcaktuara nga e paditura e dytë, gjë që i njëjti në bazë të shkresave të lëndës, qartazi nuk i ka plotësuar. Gjykata refuzoi po ashtu pretendimet e paditësit me të cilat pretendon që kemi shkelje të pastërt ligjore e cila duhet të evitohet nga e paditura e dytë, duke marrë parasysh kërkesën e saj për plotësim dokumentacioni, si të tërësisht të pabazuar. Kjo për faktin që me rastin e detyrimit nga Gjykata përmes Aktgjykimitin paraprak për të vendosur në lidhje me kërkesën e palës paditëse, e paditura ka ndërmarrë në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, duke rifilluar procedurën administrative dhe duke rikërkuar nga pala paditëse plotësimin e kërkesës për leje me dokumentet specifike. Thënë këtë, është evidente që e paditura e dytë ka vepruar gjatë tërë kohës me kompetencë dhe në përputhje me autorizimet e veta ligjore duke zhvilluar procedurën administrative sipas kërkesës së Gjykatës dhe brenda kufijve të vet ligjor. Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës së dytë ndaj kërkesës së palës dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform autorizimeve të veta me ligj. Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.”

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ngase provat e prezantuara me ankesë nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, konkretisht nenit 21 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim.

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.289/2024, datë 03.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti